



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 271/3 Prot.

Tiranë, më 29.06.2020

VENDIM

Nr.45, datë 29.06.2020

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 104, DATË 30.10.2019,
NË INSTITUCIONIN BASHKIA SHIJAK**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraparak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 104, datë 30.10.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Shijak, në bazë të urdhrit nr. 65, datë 12.09.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në përgatitjen e strukturës dhe organigramës të kësaj bashkie”*,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, *“Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”*, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku u përfshi dhe Bashkia Shijak.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Shijak, vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 104, datë 30.10.2019, duke i

lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 3 (tre) muajsh për zbatimin e tyre.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Bashkia Shijak, me shkresën nr.271/1 prot., datë 22.01.2020 dhe përmes komunikimit në rrugë elektronike me e-mail të datës 17.06.2020, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Bashkia Shijak, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Institucioni ka marrë masa dhe ka rikthyer gjendjen e ligjshmërisë për 2 rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, më konkretisht për: ***** dhe *****.
2. Njësia përgjegjëse ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit për punonjësen ***** , në përputhje me detyrën e lënë nga Komisioneri.
3. Njësia përgjegjëse ka realizuar procedurat e konkurrimit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.
4. Institucioni i mbikëqyrur, me Vendimin nr. 23, datë 29.01.2020, ka miratuar planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin 2020.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 104, datë 30.10.2019, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Shijak, në bazë të urdhrit nr. 65, datë 12.09.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione

pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në përgatitjen e strukturës dhe organigramës të kësaj bashkie”.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Shijak.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Shijak.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha